

VENDIM
Nr. 123, datë 4.4.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË FSHATIN SHEQ
MARINAS, TOPOJË, BASHKIA FIER**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 297, datë 17.11.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/9 prot., datë 30.3.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 20.2.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.2.2023 dhe 22.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 571/3 prot., datë 3.3.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 571/4 prot., datë 7.3.2023.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar një korrespondencë të mëtijshme me shoqërinë për të sqaruar dokumentacionin që duhet të depozitonte në kuadër të këtij aplikimi, e po ashtu formën e depozitimit të tij, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 20.3.2023, u vendos zgjatja deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571/7 prot., datë 21.3.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë

elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, germat “a”, “b”, “d” “e” dhe “f”.

- Për sa parashikuar në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit dhe duke iu referuar deklaratës së shoqërisë se nuk ka filluar ende punimet, vlerësohet që t’i lihet kusht që të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaiq, deri në datën 6.9.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).

- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga sa deklarohej nga shoqëria rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARI I BORDIT
Maksim Shuli